



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2588/8 Prot.

Tiranë, më 28.10 2025

V E N D I M

Nr. 146 dt. 28.10 2025

**“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË
RREGULLOREN E KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK”**

Mbështetur në nenin 3, pika 2/c dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7, pika 2/c dhe nenin 20, të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.10.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik sipas këtyre përcaktimeve:

2. Neni 22, pika 3, ishte:

Kopje elektronike e të gjithë dokumentacionit të kandidatit të rregjistruar në 2 (dy) CD ose në memory stick, apo në një mjet tjetër të ruajtjes elektronike të të dhënave. Një kopje arkivohet në njësinë kryesore, ndërsa kopja tjetër është pjesë përbërëse dhe ruhet në dosjen e kandidatit,

bëhet:

Kopje elektronike e të gjithë dokumentacionit të kandidatit të rregjistruar në 2 (dy) CD ose në memory stick, apo në një mjet tjetër të ruajtjes elektronike të të dhënave. Materiali në CD ose në memory stick të jetë në një format lehtësisht të aksesueshëm. Një kopje arkivohet në njësinë kryesore, ndërsa kopja tjetër është pjesë përbërëse dhe ruhet në dosjen e kandidatit.

3. Neni 24, pika 1 ishte:

1. Detyra të njësisë bazë:

Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes në dorëzim të dosjes së kandidatit, njësia bazë, vlerëson dosjen e kandidatit për titullin akademik "Profesor" ose "Profesor Asociuar" dhe e përcjell atë për procedim të mëtejshëm në Senatin Akademik.

Brenda 20 (njëzetë) ditëve nga marrja e dosjes, Senati Akademik shqyrton dosjen dhe e përcjell për vlerësim në KPPA.

Vlerësimi i dosjeve të kandidateve bëhet në përputhje me kriteret dhe standardet shtetërore të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 112, datë 23.02.2018, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor " dhe të standardeve shtetërore përfitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar " dhe "Profesor", i ndryshuar, si dhe bazuar në këtë rregullore,

bëhet :

Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes në dorëzim të dosjes së kandidatit, njësia bazë, vlerëson dosjen e kandidatit për titullin akademik "Profesor" ose "Profesor Asociuar" dhe e përcjell atë për procedim të mëtejshëm në Senatin Akademik.

Në momentin e vlerësimit të dokumentacionit, njësia bazë ka detyrimin që të përcaktojë qartë numrin e artikujve, botimeve apo referimeve të cilat janë në përputhje me fushën e ekspertizës së kandidatit.

Brenda 20 (njëzetë) ditëve nga marrja e dosjes, Senati Akademik shqyrton dosjen dhe e përcjell për vlerësim në KPPA.

Vlerësimi i dosjeve të kandidateve bëhet në përputhje me kriteret dhe standardet shtetërore të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 112, datë 23.02.2018, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor " dhe të standardeve shtetërore përfitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar " dhe "Profesor", i ndryshuar, si dhe bazuar në këtë rregullore.

Procedura e vlerësimit të dosjes mbetet e njëjtë.

4. Ky Vendim i përcillet për njohje KPPA dhe të gjitha njësive përbërëse të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

